



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datën **30.01.2024, Nr. 81 Regj. Themeltar**, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Bashkimin e dënimit penal të dhënë me vendimin nr.175, datë 24.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnjë, me dënimin e dhënë me vendimin nr.41, datë 26.05.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke caktuar një dënim të vetëm ndaj të dënuarit **Gentian Gjeka (Xheka)**.
2. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja **Flora Hajredinaj**, me vendimin Nr. **81**, datë 26.06.2024 vendosi:
 1. Bashkimin e dënimit penal të dhënë me vendimin nr.175, datë 24.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnje, me dënimin e dhënë me vendimin nr.41, datë 26.05.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke i caktuar të dënuarit **Gentian Gjeka (Xheka)**, i biri i Nikoll-ës dhe Farije, i datelindjes 05.05.1981, lindur në Divjakë dhe banues në Xengë, Bashkia Divjakë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me gjendje civile i divorcuar, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, me një dënim të vetëm prej 9(nëntë)vjet e 2 (dy) muaj burgim.
 2. Vuajtja e dënimit fillon nga dita e arrestimit në flagrancë, datë 5.4.2019 dhe të kryhet/vijojë në një burg të sigurisë së lartë.
 3. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 26.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar